

Piccola Opera della Divina Provvidenza

- Don Orione -

Figli della Divina Provvidenza

Piccole Suore Missionarie della Carità



125 VJETORI I SHUGURIMIT MESHTARAK I DON ORIONES

TË DËGJOSH, TË SHQYRTOSH DHE TË JETOSH MISIONIN

Romë, 3 Korrik 2018

Të dashur të rinj,
të dashur përgjegjës të Baritores Rinore
të Familjes Orionine

Jemi të lumtur që ju shkruajmë këtë letër. Është gjithmonë bukur të gjendet mundësia për t'ju takuar.

Me siguri e keni kuptuar që në muajt e ardhshëm do të jeni protagonistë të shumë eventeve kishtarë. Po! Shumë prej tyre ju përkasin ju. Le të mendojmë për Asamblenë e Përgjithshme të XV të Sinodit të Ipeshkëvinjeve, që në tetor të këtij viti do të mbahet në Romë dhe sikurse e dini, tema kryesore është "Të rinjtë, feja dhe shqyrtimi". Rruga e përgatitjes për këtë takim të rëndësishëm ka qënë intensive dhe po na përfshin të gjithëve; presim fryte bujare nga kjo asamble e ipeshkëvinjeve me Papa Françeskun. Pastaj menjëherë, në Janar të 2019, do të zhvillohet Dita Botërore e Rinisë në Panama që ka si temë "Ja shërbëtorja e Hyjit, u bëftë në mua sipas fjalës tënde" (Lk 1,38); edhe këtu do të celeburojmë thirrjen dhe përgjigjen e Hyjit në shembullin e Marisë. Ndër të tjera, do të jenë edhe shumë aktivitete që si Familje Orionine do jetojmë së bashku: ecja e formimit, takimet me të rinjtë e tjerë, misionet e fesë dhe dashurisë që do i bëjmë vepra për të qënë një Kishë në dalje, për një shoqëri më vëllazërore.

Në horizontin e ecjes tonë duam tu propozojmë festimin e një festë. Me 23 prill 2020 do të festojmë 125 vjetorin e shugurimit meshtarak të Don Oriones. Ai, kur u shugurua, ishte 23 vjeç: pak me pak se ju apo ndoshta të njejtën moshë që keni. Kjo ngjarje transformoi jetën e tij. Përveç faktit kronologjik, dimë që çdo moment i jetës tonë është i përshtatshëm për të mirëpritur propozimin e Jezusit për të qënë të Tij, për të qënë gjithcka për të varfërit.

DBRO - TORTONA 2020

Ati ynë Luigji Orione, si në kohët e "Oratorit Don Orione" nuk ka mundur ta jetojë këtë ëndërr të madhe pa e bashkëndarë me të rinj të tjerë. Gjithmonë e kemi gjetur afër jush, duke nderur shkëndijën e fesë së vërtetë dhe të një dashurie pa kufi. Duam që edhe ne të rindezim këtë fe dhe misionin e dashurisë. Prandaj propozimi është i thjeshtë, **të realizojmë një takim në Tortona (Itali) nga 1 deri me 5 korrik 2020 për të gjithë të rinjtë orioninë të botës** duke celebruar dhuratën e madhe e të pasurit një baba, që na ka mbledhur si familje. Për të jetuar këtë ngjarje si një ecje të vërtetë shpirtërore, karizmatike dhe misionare, do të përjetojmë sëbashku **Vitin e Të Rinjve Orioninë nga 1 qershor 2019 deri me 30 qershor 2020**. Tema që do të gjallërojë të gjitha eksperiencat tona është: **"Të dëgjosh, të shqyrtosh dhe të jetosh misionin"**

Pse është kaq e rëndësishme kjo hapësirë kohore? Sepse duam të rinovojmë dhe të jetojmë eksperiencën e të qënurit orioninë, në mënyrë të tillë që Don Orione të mbështetet tek ne; tek ti. Me këtë iniciativë duam të bëjmë një eksperiencë familjeje dhe Kishe Universale, të thellojmë ecjen e besimit dhe kuptimit të përkatësisë në familjen orionine, të përjetojmë momente të thella përsëritërie, të dëgjojmë apelin e Hyjit që thërret, të dëshmojmë entuziazmin e thirrjes tonë si të rinj misionarë, të njohim dhe të krijojmë bashkëpunime me realitete të tjera rinore.

Ju kujtohet kur Don Orione takoi Mario lvaldin, djalin që kishte vendosur të mos shkojë më në katekizëm? Në ato rrethana, Luigji vendosi të lërë çdo gjë që po bënte për ta dëgjuar dhe ngushëlluar. **Takimi nuk i la më njësoj: ndryshoi rrënjësisht jetën e të dyve**. Sigurisht, sepse kur dy të rinj ëndërrojnë bashkë gjithçka bëhet e re: *"Dëshiron të kthehesh nesër në të njëjtën orë?"* i thotë Luigji djalosht Mario; *"Më gjej shokët e tu. Mi sill ata këtu! Sepse dua të formoj një grup të vogël ose orator; e pastaj do e shikosh sa vepra të bukura do të bëjmë"*. Po, me siguri i kujtoni mirë këto fjalë, sepse një ditë i keni dëgjuar edhe ju kur ju kanë ftuar për tu bërë pjesë e oratorit veror, ose të grupit rinor të famullisë, në shkollë ose në Kotolengo. Kjo ftesë për të bërë të parin hap ndër shumë të tjerë, është një eksperiencë që rinovohet në zemrën e shumë të rinjve deri sot.

Por çdo gjë nuk mund të mbetet fjalë. **Nga ai takim plot me besim e gëzim, ka lindur një mision:** të jetosh çdo takim me të tjerët gjithmonë nën shenjën e dashurisë. Në këtë prespektivë mirëbesimi dhe dashurie, është e sigurtë që keni përjetuar praninë e Hyjit pikërisht në jetën tuaj. Ne takojmë Hyjin duke ju shërbyer të tjerëve. Por shërbimi ndaj të tjerëve sjell sakrificën e vetë jetës. Pa njësi matëse, ose më mirë, me njësinë e vetme matëse, ajo e kapacitetit për të dashur me zemrën tonë. Dhe ky mision impenjues, por që mbush jetën me lumturi, Don Orione ja propozon një të riu tjetër që quhej Biaggio Marabotto, kur duke e ftuar të bëhej pjesë e familjes tonë, e siguron që: *"në bëjmë një jetë të lumtur sepse ne fund na mjafton që të kemi Jezusin"*

Por kjo jo gjithmonë është kaq e qartë. Si ta takojmë Jezusin në jetën tonë dhe në historinë e komunitetit tonë? Si ta dallojmë fjalën e Shpirtit të Shenjtë në mes të shumë fjalëve të tjera që dëgjojmë? Dhe prapë, si t'ja bëjmë të marrim

vendimin e duhur: ai që shpërthen portat e lumturisë tonë? Ngjarjet e jetës sonë janë të shurdhëra ose të paqarta, dhe në përfundim mund të na japin interpretime të ndryshme. Të ndriçosh kuptimin e tyre me rregull deri në një vendim, kërkon një rrugë shqyrtimi. Cili ka qënë atëherë **stili i shqyrtimit** me të cilin Don Orione ndihmoi shumë të rinj që të marrin vendimet më të rëndësishme të jetës së tyre? Ai ishte një Atë për shumë të rinj, duke i ndihmuar të dëgjojnë zërin e Hyjit në zemrat e tyre; duke bërë që të lindë në to feja e themeluar në eksperiencën historike se Provania Hyjnore i do të gjithë, duke bërë në mënyrë të tillë që gjithçka kontribon për të mirën, që më në fund të ndizet në secilin prej atyre, ne fillim shkëndija dhe pastaj *“dy flakët e një zjarri të vetëm, të shenjtë: të duash Hyjin dhe vëllezërit”*.

Të dashur të rinj orioninë, prandaj ju ftojme të jetoni këtë rrugëtim me bujari. Duke mos qënë spektatorë, por protagonistë të vërtetë në këtë kohë plot me eksperiencë që na ndihmojnë të ripërhapim identitetin dhe misionin tonë. Të bashkohemi me të tjerë...të organizohemi.... Takimi është një udhëtim që jetohe bashkë, në grup, me shokë të tjerë ecjeje....Ndjejmë se Don Orione ecën me ne, dhe si ka bërë me të tjerë, edhe sot na ndihmon të jetojmë me entuziazëm impenjimin tonë për të ndjekur Jezusin.

I besojmë Shën Marisë të gjitha iniciativat që do të përjetojmë në Vitin e të Rinjeve Orioninë 2019-2020 dhe në Takimin Ndërkombëtar në Tortona.

Të falemi Mari e përpara...!

Motër Maria Mabel Spagnuolo
Nëna Gjenerale PSMC

Don Tarcisio Vieira
Drejtor gjeneral FDP

Motër Maria Rosa Delgado Rocha
Këshilltare gjenerale

Don Fernando Fornerod
Këshilltar gjeneral